



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu  
Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 650

Date: 27 / 3 / 2025

Në bazë të nenit 20 (2.1, 2.2, 2.4) dhe 91 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Senati, në mbledhjen e mbajtur më 21.02.2025, miratoi:

### **RREGULLOREN E PËRGJITHSHME PËR STUDIMET E DOKTORATËS**

#### **Neni 1**

##### **Dispozitat e përgjithshme**

1. Kjo rregullore përcakton organizimin dhe zhvillimin e studimeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës (UP), duke rregulluar strukturën, kohëzgjatjen, kriteret e pranimit, procesin akademik, të drejtat dhe detyrimet e doktorantëve dhe mentorëve, si dhe sigurimin e cilësisë së studimeve.
2. Me këtë rregullore përcaktohen kriteret e domosdoshme për aktivitetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

#### **Neni 2**

##### **Definimi i nocioneve dhe përbërja e Këshillit të doktoratës të njësisë akademike dhe Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës**

Kuptimi i nocioneve sipas kësaj rregulloreje është:

1. Këshilli i studimeve të doktoratës në nivelin e njësisë akademike (fakultetit) quhet Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike, ndërsa në nivel të universitetit është Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës (KQSD).
2. Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike përbëhet nga 5 ose 7 anëtarë nga radhët e profesorëve me thirrjen së paku profesor i asociuar, të cilët përfaqësojnë

departamentet<sup>1</sup> përkatëse të njësisë akademike. Në rast të mungesës së profesorëve të asociuar, anëtarë të këshillit të studimeve të doktoratës mund të emërohen edhe profesorët asistentë, të cilët i plotësojnë kushtet për mentorim të doktorantëve (neni 9, pika 1.2). Mbledhja e parë (konstituive) ftohet dhe udhëhiqet nga dekani i njësisë akademike. Pas konstituimit, këshilli i studimeve të doktoratës e zgjedh kryetarin nga radhët e veta.

3. Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës ka këtë përbërje:

- Rektori;
- Prorektori për kërkime shkencore;
- Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e shkencave në Fakultetin Filozofik;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e shkencave filologjike;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e shkencave të inxhinierisë mekanike ose të inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e shkencave të inxhinierisë së ndërtimit ose të arkitekturës;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e arteve;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e shkencave matematike-natyrore;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e mjekësisë;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e shkencave të bujqësisë dhe veterinës;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e shkencave juridike;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e shkencave ekonomike;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e edukimit fizik dhe sportit;
- Një profesor i rregullt ose një profesor i asociuar nga fusha e shkencave të edukimit;
- Drejtori i Zyrës për Çështje Akademike (ZÇA), pa të drejtë vote.

4. Anëtarët e Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës i propozon rektori, në konsultim me dekanët e njësive akademike përkatëse dhe i emëron senati.

5. Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës kryesohet nga rektori. Në mungesë të tij/saj, këshilli kryesohet nga prorektori për kërkime shkencore. Në rastin e numrit të barabartë të votave, vota e kryesuesit është përcaktuese.

---

<sup>1</sup> Rolin e departamentit, sipas kësaj rregulloreje, varësisht nga njësitë akademike, mund ta ushtrojnë degët, përkatësisht katedrat.

6. Studimet e doktoratës mund të organizohen nga një ose më shumë njësi akademike, një ose më shumë universitete brenda dhe jashtë vendit.
7. Mentori është personi i emëruar me titull shkencor-mësimor ose artistik-mësimor, i cili e udhëheq doktorantin gjatë punimit të disertacionit të doktoratës.
8. Dosja e doktorantit është dosja e cila i përmban të gjitha shënimet qenësore të doktorantit prej momentit të pranimit të tij e deri te promovimi. Njësia akademike përkatëse është përgjegjëse për mbledhjen dhe për ruajtjen e të dhënave në dosje.

### **Neni 3**

#### **Organizimi i studimeve të doktoratës**

1. Studime të doktoratës mund të organizohen nga njësitë akademike (fakultetet) dhe/ose universiteti/universitetet në një a më shumë fusha shkencore, nëse së paku gjysma e personelit akademik të angazhuar në atë program janë në marrëdhënie të rregullt pune në UP.
2. Studimet e doktoratës mund të ofrohen dhe të realizohen vetëm në ato fusha shkencorë, në të cilët institucioni përgjegjës ka arritje të pranuar ndërkombëtare në kërkimet shkencore, përkatësisht në krijimtarinë artistike, të dëshmuara me punime të botuara në revista ndërkombëtare shkencore dhe të indeksuara në platforma kredibile ndërkombëtare, përkatësisht të prezantuara në institucione të dëshmuara kulturore/artistike jashtë vendit, në përputhje edhe me standardet në fuqi të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA).
3. Studimet e doktoratës në fushën përkatëse mund të organizohen vetëm pas akreditimit të tyre nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA).
4. Me studimet e doktoratës udhëheq Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë përkatëse akademike. Ndërsa, programet e doktoratës udhëhiqet nga përgjegjësi, i cili është bartësi i parë i programit.
5. Karakteristikat themelore të studimeve të doktoratës në universitet janë thellimi në dijen teorike specifike, në të cilën vendoset çështja kërkimore e projektit hulumtues doktoral, hulumtimi origjinal dhe inovator përmes metodave të avancuara kërkimore, ndërkombëtarizimi përmes prezantimeve dhe mobiliteteve në forume akademike, krijimi i përvojave të mësimdhënies, vlerësimi ndërkombëtar i cilësisë dhe konkurrenca ndërkombëtare.
6. Me qëllim të sigurimit të cilësisë në studimet e doktoratës dhe nxitjes së lëvizshmërisë/mobilitetit të doktorantëve dhe të stafit akademik, UP-ja është e hapur për çdo formë të bashkëpunimit me institucione të ngjashme brenda dhe jashtë vendit.

## **Neni 4**

### **Qëllimet e studimeve të doktoratës**

Qëllimet e studimeve të doktoratës janë:

1. Avancimi i njohurive dhe kërkimeve në një fushë të caktuar shkencore/artistike;
2. Nxitja e qasjes së kërkimeve ndërdisiplinare dhe bashkëpunimit ndërmjet njësive akademike;
3. Aftësimi i doktorantëve për punë të pavarur kërkimore/artistike për hulumtime të pavarura dhe për të vlerësuar në mënyrë kritike teoritë, metodologjinë kërkimore dhe gjetjet e të tjerëve;
4. Zhvillimi i njohurive, përvojave dhe shkathtësive të doktorantëve, që në mënyrë kreative dhe të mbështetur në hulumtime, të ofrojnë kontribut origjinal me rezultatet shkencore domethënëse në fushat përkatëse të dijes;
5. Krijimi i dijeve të reja teorike dhe praktike në shkencë, industri, zhvillime teknologjike ose politikëbërje, duke ndihmuar në zhvillimin e zgjidhjeve të problemeve komplekse në shoqëri;
6. Promovimi i ndërkombëtarizimit të punës kërkimore/artistike përmes krijimit të mundësive për bashkëpunime dhe shkëmbime akademike me universitete dhe institucione të njohura jashtë vendit

## **Neni 5**

### **Mësimi dhe hulumtimi në studimet e doktoratës**

1. Komponenti thelbësor i studimeve universitare të doktoratës është kërkimi dhe krijimi shkencor/artistik.
2. Format e punës, të obligueshme në studimet e doktoratës, me qëllim të zhvillimit të punës kërkimore, mendimit kritik, përvetësimit të metodologjisë dhe shkathtësive të përgjithshme, përveç tjerash, janë: seminarët, puna kërkimore, puna eksperimentale, punëtoritë dhe grupet e diskutimit.
3. Mësimi në formë të ligjëratave nuk mund të kalojë 20 përqindëshin e ngarkesës së përgjithshme të paraparë me programin e studimeve dhe të llogaritur sipas sistemit evropian të transferimit të kredive (ECTS).
4. Sipas mundësive dhe në bazë të kushteve të përcaktuara paraprakisht, ndjekja e mësimave në studimet e doktoratës është e hapur për të gjithë doktorantët e universitetit. Disa pjesë të kërkimeve dhe të mësimit në studimet e doktoratës mund të ndiqen edhe nga doktorantët e universiteteve të tjera, sipas kushteve të parapara në kontratën paraprakisht të nënshkruar ndërmjet universiteteve në fjalë.
5. Me qëllim të arritjes së interdiciplinaritetit dhe në bazë të arsyetimit dhe pëlqimit të mentorit, si dhe të pëlqimit të Këshillit të studimeve të doktoratës, doktorantët mund të



kryejnë pjesë të caktuara të kërkimit dhe të krijimtarisë artistike edhe në njësitë e tjera akademike të universitetit ose në institucione të tjera përkatëse brenda dhe jashtë vendit.

6. Këshilli i studimeve të doktoratës mund t'u caktojë doktorantëve lëndë plotësuese nga grupi i lëndëve brenda programit të akredituar për arritjen e njohurive dhe shkathtësive themelore, të domosdoshme për vijimin dhe përfundimin e studimeve, por jo me qëllim të zëvendësimit të kredive ECTS, të parapara të arrihen me aktivitete të formave të tjera.

## **Neni 6**

### **Format e studimeve të doktoratës**

1. Studimet e doktoratës mund të organizohen në një të një prej këtyre formave:
  - 1.1. Studimet e doktoratës, për organizimin e të cilave përgjegjës është vetëm një njësi akademike ose universiteti;
  - 1.2. Doktorata e dyfishtë, në të cilën doktoranti i merr dy diploma dhe për të cilën është i obliguar edhe mentorimi i dyfishtë (modeli: cotutelle de thèse). Aplikohet në rastet kur me marrëveshje të veçantë, doktoranti regjistrohet në studimet e doktoratës në dy universitetet partnere dhe të dy universitetet emërojnë mentorin përkatës për doktorantin. Procedurat e regjistrimit të doktorantëve dhe realizimit të studimeve të doktoratës parashihen në marrëveshjen e veçantë, të lidhur ndërmjet dy universiteteve (nenet 76, 77 dhe 78);
  - 1.3. Studimet e përbashkëta si program i akredituar i dy ose më shumë universiteteve, nga të cilat së paku një universitet është jashtë Republikës së Kosovës. Secili universitet merr pjesë në regjistrimin e doktorantëve, ndërsa doktoranti mund të fitojë një diplomë të vetme të dy ose më shumë universiteteve ose diplomën e universitetit, në të cilin i ka regjistruar studimet e doktoratës, në të cilën shkruan se studimet kanë qenë të përbashkëta me partner ndërkombëtar.
2. Nuk lejohet transferimi i studentëve të doktoratës nga një program në tjetrin brenda njësisë akademike të Universitetit të Prishtinës, e as nga universitetet e tjera në Universitetin e Prishtinës. Studentët pranojnë vetëm në bazë të konkurrimit në konkursin e shpallur.

## **Neni 7**

### **Numri i studentëve, konkursi dhe kushtet e regjistrimit në studime të doktoratës**

1. Njësitë akademike propozojnë numrin e studentëve për regjistrim, në pajtim me kushtet e përcaktuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, ndërsa senati e merr vendimin përfundimtar për numrin e studentëve dhe shpalljen e konkursit publik, duke pasur parasysh kapacitetet hulumtuese, mësimore dhe mentoriale të njësisë akademike.
2. Kushtet e regjistrimit i përcakton senati i universitetit, me propozimin e KQSD-së dhe në pajtim me këtë rregullorë.

3. Konkursi publik për regjistrim në studime të doktoratës shpallet nga senati i universitetit. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë kandidatët me notë mesatare të të dy niveleve të studimeve (BSc +MSc)/2  $\geq$ 8.00), jo më të ulët se 8, të diplomuar në njërin nga nivelet vijuese:
  - 3.1. Të diplomuarit para hyrjes në fuqi të studimeve, sipas Deklaratës së Bolonjës, të cilët duhet të jenë magjistra të shkencës përkatëse;
  - 3.2. Të diplomuarit pas hyrjes në fuqi të studimeve në bazë të Deklaratës së Bolonjës, niveli i studimeve master shkencor;
  - 3.3. Të diplomuarit që kanë së paku 300 kredi European Credit Transfer (ECTS). Ekuivalentimin e notave për studentë nga jashtë Kosovës e bën Komisioni për pranimin e studentëve.
4. Senati i universitetit, me propozimin e njësisë akademike dhe pas shqyrtimit në Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës, merr vendim përfundimtar për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Lista me kandidatët e pranuar shpallet me të gjitha të dhënat e kritereve të përzgjedhjes, publikisht në uebfaqen e njësisë akademike dhe në uebfaqen e universitetit.
5. Parakusht për vlerësimin e kandidatëve është dorëzimi i dokumentacionit përkatës nga ana e tyre ku, përveç tjerash, duhet të përfshihen: letra motivuese, në të cilën arsyetohet interesi për kërkime shkencore/artistike në fushën përkatës; koncepti ideor i hulumtimit; dëshmitë lidhur me suksesin në secilin nivel të studimeve paraprake; dëshmitë për njohjen e gjuhës angleze nga ndonjë institucion i njohur dhe i pranuar në nivel ndërkombëtar; dëshmitë lidhur me publikimet përkatëse (shkencore/artistike) nëse ka, si dhe letër zotimi apo konfirmimi i një profesori në fushën përkatëse se është i gatshëm të mentorojë kandidatin në temën përkatëse. Lista e plotë e dokumentacionit të nevojshëm për vlerësimin e kandidatëve specifikohet në konkursin publik.
6. Koncepti ideor i hulumtimit duhet të prezantohet para komisionit për vlerësimin e aplikantëve. Ky komision, caktohet nga këshilli i fakultetit për secilin program, dhe përbëhet nga anëtarë që plotësojnë kriteret për mentorim. Komisioni bën vlerësimin e konceptit ideor, i cili duhet të përfshijë së paku komponentët në vijim:
  - Titulli;
  - Abstrakti;
  - Hyrja;
  - Çështja kërkimore, pyetja/et kërkimore dhe hipoteza/t;
  - Korniza teorike, literatura relevante;
  - Inovacioni, relevanca dhe kontributi i synuar shkencor;
  - Të dhënat dhe metodologjia e propozuar;
  - Metoda/t e analizës së të dhënave;
  - Plani i punës;

- Referencat.

7. Koncepti ideor i hulumtimit vlerësohet deri në 40 pikë, kriteret e detajuara të vlerësimit të konceptit ideor përcaktohen për secilin program dhe shpallet në konkurs.
8. Njësitë akademike, së bashku me kërkesën për konkurs, duhet ta dërgojnë edhe listën e mentorëve që i plotësojnë kushtet për mentorim.
9. Kriteret e përcaktimit të përparësisë në radhitjen e kandidatëve janë:
  - 9.1. Kandidatët duhet t'i kenë të përfunduara studimet paraprake në fushën e njëjtë ose të afërt me studimet e doktoratës. Fushat e afërta përcaktohen nga njësia akademike përkatëse, vlejnë për tërë periudhën e akreditimit të programit përkatës dhe publikohen në konkurs, në kuadër të kushteve të veçanta për njësinë akademike përkatëse. Vlerësimi i fushave të kandidatëve, të cilët studimet i kanë kryer në fakultete ose universitete tjera, bëhet nga ana e Këshillit të studimeve të doktoratës, para se ata t'i nënshtrohen prezantimit publik.
  - 9.2. Nota mesatare gjatë studimeve në nivelin baçelor dhe master, përkatësisht nota mesatare e studimeve të integruara, vlerësohet maksimalisht me 40 pikë, të cilat llogariten duke shumëzuar notën mesatare aritmetike me 4.
  - 9.3. Aktiviteti kërkimor-shkencor/profesional, siç dëshmohet me botimet dhe prezantimet si në vijim, vlerësohet me vlerë maksimale deri në 20 pikë:
  - 9.4. Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit dhe të indeksuara në Web of Science (SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe/ose SCOPUS (Q1, Q2): autori i parë/korrespondent 5 pikë, bashkautori 2 pikë;
  - 9.5. Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit dhe të indeksuar në SCOPUS (Q3, Q4) autori i parë/korrespondent 3 pikë, bashkautori 1 pikë;
  - 9.6. Për fushën e mjekësisë për specializimin e përfunduar vlerësohet me 5 pikë.
  - 9.7. Për çdo artikull të botuar në pesë vjetët e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara: autori i parë 3 pikë, i dyti 2 pikë, të tjerët 1 pikë;
  - 9.8. Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit në revista akademike vendore, që botohen nga Universiteti i Prishtinës ose nga qendrat apo institutet e tij, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, nga Instituti Albanologjik dhe nga Instituti i Historisë, të cilat i nënshtrohen recensionit shkencor: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë;
  - 9.9. Për çdo prezantim gojor të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore të indeksuar dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë;
  - 9.10. Për çdo prezantim në formë posterit të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore, të indeksuar dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë;

- 9.11. Për çdo prezantim gojor në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) shkencore me karakter vendor: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.
10. Publikimet në revista dhe botues të dyshimtë, siç janë të definuara në rregulloren në fuqi për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin e personelin akademik, nuk merren parasysh. Në këtë rregullore, ky kufizim është i aplikueshëm edhe në rastet tjera kur bëhet fjalë për revista dhe botues të tyre.
  11. Në rastin e pikëve të barabarta, përparësi i jepet kandidatit që është staf i rregullt i UP-së.
  12. Kandidatët mund të fitojnë 40 pikë nga nota, 20 pikë nga kontributet shkencore/artistike dhe maksimalisht 40 pikë nga prezantimi i konceptit ideor.
  13. Çdo kandidat duhet të dëshmojë njohuri të gjuhës angleze, të paktën në nivelin B2, përkatësisht të ketë dëshmi nga testet ndërkombëtare të njohura, TOEFL iBT (minimumi 72 pikë) ose IELTS (minimumi 5.5). të administruara nga institucione të akredituara sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (CEFR). Certifikatat e TOEFL iBT dhe IELTS janë të vlefshme për 2 vjet nga data e lëshimit të tyre.
  14. Njësitë akademike mund të vendosin kërkesa plotësuese, nëse të njëjtat nuk bien ndesh me Statutin e UP-së dhe me këtë rregullore. Kërkesa/t plotësuese specifikohen në konkursin përkatës, të publikuar pas akreditimit të programit të doktoratës dhe vlejnjë për tërë periudhën e akreditimit.
  15. Procesi i pranimit organizohet dhe administrohet nga njësitë akademike, duke respektuar standardet më të larta akademike. Në rastet e prezencës së konfliktit të interesit, duhet të evitohet në tërësi përfshirja e personelit përkatës në të gjitha fazat e procesit pranues. Në rastet e tilla senati i universitetit mund të kërkojë nga fakulteti që të marrë masa shtesë me qëllim të evitimit të diskreditimit të procesit pranues.

## **Neni 8**

### **Kohëzgjatja dhe fazat e studimeve të doktoratës**

1. Studimet e doktoratës janë studime me orar të plotë dhe zgjasin jo më pak se tre vjet, përkatësisht organizohen në gjashtë semestra. Studimet e doktoratës duhet të përmbyllen me mbrojtjen publike të temës së doktoratës më së largu brenda gjashtë (6) vjetësh nga dita e regjistrimit të tyre. Me propozim të arsyetuar të Këshillit të studimeve të doktoratës, këshillit të fakultetit dhe Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës si dhe pas aprovimit nga ana e senatit, studimet e doktoratës mund të vazhdojnë edhe për dy vjet. Nëse brenda kësaj periudhe doktoranti nuk arrin t'i përfundojë studimet e doktoratës nëpërmjet mbrojtjes publike të punimit të doktoratës, ai/ajo e humb statusin e doktorantit.
2. Me rastin e humbjes së statusit të doktorantit, universiteti lëshon certifikatë që konfirmon këtë si dhe dëshmi për kurset e përfunduara. Certifikata e lëshuar nënshkruhet nga dekani i njësisë përkatëse.

1. Me kërkesë dhe arsyetim specifik të parashtruar nga doktoranti dhe pëlqim të mentorit, doktoranti mund të kalojë në studime me orar jo të plotë (part-time) për një periudhë prej jo më shumë se dy vite konsekuive akademike (d.m.th. një vit akademik me orar të plotë), si dhe jo më shumë se tre vjet në total gjatë tërë periudhës së studimeve. Në këto raste, kërkesa e doktorantit duhet të ketë paraprakisht aprovimin e Këshillit të studimeve të doktoratës së njësisë akademike, Këshillit të fakultetit përkatës dhe Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës.
2. Për programet e akredituara, grumbullimi i kredive ECTS bëhet në përputhje me programet përkatëse.
3. Organizimi dhe realizimi i planprogramit për semestrat 1 dhe 2 udhëhiqet nga përgjegjësi i programit, i caktuar nga njësi akademike. Në fillim të semestrit të dytë, doktoranti, në konsultim me mentorin potencial, propozon fushën e ngushtë të hulumtimit dhe temën potenciale të punimit të doktoratës (Formulari F1). Propozimi i doktorantit për temën dhe mentorin potencial (Formulari F1) shqyrtohet në këshillin e fakultetit, bazuar në vlerësimin e këshillit të doktoratës dhe të departamentit përkatës. Këshilli i fakultetit, bazuar në kriteret e specifikuar në këtë rregullore, mund t'i rekomandojë doktorantit rishqyrtim të propozimit për mentorin dhe temën, para se doktoranti të thellohet në fushën e hulumtimit.
4. Për të regjistruar semestrin e tretë, doktoranti duhet të ketë grumbulluar së paku 45 ECTS nga dy semestrat paraprakë. Nga totali prej 60 ECTS-ve të mundshme për semestrin e parë dhe të dytë, 36 ECTS doktoranti i fiton nga ligjëratat dhe provimet, ndërsa 24 ECTS i fiton pas vlerësimit pozitiv të projekt-propozimit të doktoratës, ku njëkohësisht caktohet edhe mentori zyrtar (ratifikimi në senat). Për të regjistruar semestrin e katërt, doktoranti duhet të ketë grumbulluar të paktën 60 ECTS, ndërsa regjistrimin e semestrave pasues mund ta bëjë edhe duke akumuluar gradualisht ECTS.
5. Pjesa e mbetur nga 120 ECTS-të e nevojshme për doktoratën fitohet gjatë punës kërkimore të realizimit të projektit të doktoratës, përkatësisht:
  - 5.1. Publikimi si autor i parë i së paku një punimi të një pjese të rezultateve të doktoratës në revista ndërkombëtare, të indeksuara në përputhje me rregulloren në fuqi për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin e personelit akademik (30 ECTS), mentori duhet të jetë pjesë e punimit;
  - 5.2. Publikimi si autor i parë i së paku një punimi të një pjese të rezultateve të doktoratës në revista akademike vendore, që botohen nga Universiteti i Prishtinës ose nga qendrat apo institutet e tij, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, nga Instituti Albanologjik dhe nga Instituti i Historisë, dhe të cilat i nënshtrohen recensionit shkencor (5 ECTS);
  - 5.3. Së paku një prezantim jashtë vendit, si autor i parë konferenca, kongrese, etj., me karakter ndërkombëtar (10 ECTS);
  - 5.4. Doktorantët që nuk kanë publikuar të paktën një punim në revista vendore duhet të kenë së paku një prezantim si autor i parë në tubime shkencore (konferenca,



kongrese, etj.) me karakter ndërkombëtar, ose së paku dy prezantime si autor i parë në tubime shkencore (konferenca, kongrese, etj.) me karakter kombëtar.

5.5. Përfundimi dhe mbrojtja publike e punimit të doktoratës vlerësohet me 75 ECTS;

5.6. Të gjitha publikimet dhe prezantimet e doktorantit duhet të kenë pëlqimin paraprak të mentorit dhe të jenë të afiliuara me Universitetin e Prishtinës.

## **Neni 9**

### **Mentorimi**

1. Nga momenti i futjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të drejtë për të udhëhequr kandidat për doktoratë ka:
  - 1.1. Mësimdhënësi me titull akademik profesor i rregullt (prof.) ose profesor i asociuar (prof. asoc.), i cili është në marrëdhënie të rregullt punë në UP dhe i cili ka së paku tri (3) punime në fushën përkatëse (si autor i parë, autor korrespondent, ose bashkautor), të botuara në 5 vjetët e fundit në revista të indeksuara në përputhje me Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP.
  - 1.2. Përrjashtimisht, me kërkesë të këshillit të fakultetit, për mentor mund të angazhohet edhe mësimdhënësi me titull akademik profesor asistent (prof. asst.), i cili ka së paku 3 vjet përvojë në hulumtim dhe i cili në 3 vjetët e fundit ka të publikuara së paku tri (3) punime si autor i parë/korrespondent në fushën përkatëse, në përputhje me Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP.
  - 1.3. Dëshmia për publikimin e punimeve të udhëheqësit të kandidatit për doktoratë duhet të sillet në Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës;
  - 1.4. Publikimet në revista dhe botues të dyshimtë, siç janë të definuar në rregulloren në fuqi për procedurat përzgjedhëse lidhur me personelin akademik, nuk merren parasysh;
  - 1.5. Bashkëmentor, në rast të veçantë, mund të jetë edhe profesori emeritus, ndërsa vendimin për këtë e merr senati, me propozim të Këshillit të doktoratës të njësisë akademike, në kuadër të së cilës organizohen studimet ose të këshillit të lëmit shkencor.
2. Për programet e akredituara më herët, kriteret për udhëheqësin e doktorantëve mbeten siç janë të rregulluara në vendimet e akreditimit ose rregulloret përkatëse. Për kritere të veçanta që nuk janë të përshkruara në këtë rregullore, do të vendos Senati, pas propozimit të KQSD-se.
3. Mentori, pa përjashtim, duhet të jetë nga njësia akademike dhe i fushës gjegjëse shkencore, nga e cila përgatitet punimi i doktoratës. Në këtë aspekt merret parasysh edhe fusha e publikimeve shkencore të mentorit.

4. Për të siguruar cilësi të punimit të doktoratës, nëse është e nevojshme (p.sh. kur hulumtimi është ndërdisiplinor, kërkimi/krijimi shkencor ose artistik zhvillohet në disa institucione, mund të propozohet emërimi i bashkëmentorit (komentorit) nga një departament tjetër i njësisë akademike, njësi akademike tjetër e UP-së apo ndonjë universitet tjetër, i cili është së paku i ranguar në pozitë më të lartë se Universiteti i Prishtinës në “Times Higher Education Ranking (THE)”. Roli i secilit bashkëmentor duhet të sqarohet qartë në fomularin F1.
5. Një mentor mund të marrë për udhëheqje më së shumti dy doktorantë të regjistruar brenda një viti akademik, por jo më shumë se tre (3) doktorantë njëkohësisht. Përgjatë, një profesor mund të marrë për udhëheqje edhe deri në dy (2) kandidatë shtesë, nëse kandidatët ekzistues kanë kaluar dyfishin e kohës së paraparë për përfundimin e studimeve, dhe nëse kandidatët janë të punësuar me orar të plotë në një projekt shkencor që realizohet në UP.
6. Bashkëmentorin duhet të posedojë kualifikimet e njëjta ose ekuivalente me mentorin.
7. Bashkëmentorin e bashkudhëheq doktorantin në çështjet e dakorduara paraprakisht me mentorin.
8. Një bashkëmentor nuk mund të jetë i përfshirë në monitorimin e më shumë se tre doktorantëve njëkohësisht.
9. Për një punim të doktoratës nuk mund të emërohen më shumë se një bashkëmentor.
10. Para se ta marrë detyrën e mentorit për herë të parë, secili mentor duhet ta kalojë punëtorinë (trajnimin) e mentorimit, të cilën e organizon Universiteti i Prishtinës ose shkolla të njohura ndërkombëtare.
11. Mësimdhënësi i një njësie akademike të Universitetit të Prishtinës (UP) mund të jetë mentor në ndonjë universitet tjetër, nëse ka miratim me shkrim nga këshilli i njësisë akademike të UP-së.
12. Mentori/bashkëmentorin, dhe anëtarët e komisioneve vlerësuese të cilët janë emëruar në këtë funksion para se të pensionohet, kanë të drejtë ta kryejë mentorimin deri në fund, por jo më larg se deri në moshën 70-vjeçare.
13. Për mentor/bashkëmentor dhe anëtar të komisioneve vlerësuese nuk mund të propozohet personi në marrëdhënie familjare (bashkëshort/e, partner/e, anëtar/e i/e familjes së ngushtë).

## **Neni 10**

### **Obligimet e mentorit**

1. Mentori e ka obligim ta udhëheqë doktorantin gjatë punës së punimit të doktoratës, ta përcjellë cilësinë e punës së doktorantit, ta përkrahë publikimin e punimeve të tij dhe pjesëmarrjen në projekte shkencore dhe artistike.

2. Në rastet e caktuara, kur doktoranti udhëhiqet nga më shumë se një mentor, secili prej tyre i mban përgjegjësitë e veta për pjesën e hulumtimit, paraprakisht të përcaktuar dhe për procedurën e punës në punimin e doktoratës.
3. Mentori ka obligim që një herë në vit t'i paraqesë raport për punën e doktorantit Këshillit të studimeve të doktoratës të njësisë akademike, në formular (F11) të universitetit.

## **Neni 11**

### **Obligimet dhe të drejtat e doktorantit**

1. Doktoranti është i obliguar një herë në vit, në formular të universitetit (F10), t'ia paraqesë Këshillit të studimeve të doktoratës raportin për punën e tij (me mundësi të prezantimit të hulumtimit).
2. Doktoranti ka të drejtë një herë gjatë studimeve të bëjë kërkesë me shkrim për ndërrim të mentorit dhe temës, por jo pas aprovimit në senat të projektpropozimit dhe temës. Përrjashtimisht, në rast të paaftësisë së mentorit për vazhdimin e mentorimit (të dëshmuar me vërtetim të mjekut specialist), në rast të vdekjes së tij ose në rast të konstatimit të shkeljeve përkatëse për mentorin nga ana e instancave përkatëse ligjore brenda ose jashtë UP-së, doktoranti mund të kërkojë nga senati lejimin e ndërrimit të mentorit (dhe të temës, sipas nevojës), edhe në fazë të mëvonshme. Në rastin e tillë, procedura e aprovimit të mentorit dhe temës përsëritet.
3. Doktoranti është i obliguar të grumbullojë numrin e nevojshëm të kredive (ECTS), nëpër fazat përkatëse të studimit, siç parashihet në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 12**

### **Procedura e paraqitjes së temës, mentorit dhe projektpropozimit të doktoratës**

1. Gjatë vitit të parë të studimeve të doktoratës, përkatësisht në semestrin e dytë, doktoranti e propozon mentorin (sipas rastit edhe mentorin tjetër ose bashkëmentorin) dhe temën e punimit të doktoratës. Propozimi i tillë (formulari F1) bëhet në konsultim me mentorin potencial dhe duhet të përmbajë edhe fushën e ngushtë të hulumtimit.
2. Në kuadër të formularit për paraqitjen e temës dhe mentorit (F1) doktoranti nënshkruan edhe deklaratën se nuk ka paraqitur punim doktrate me të njëjtën temë në studime të tjera universitare, përkatësisht në ndonjë universitet tjetër.
3. Doktoranti fillon procedurën e paraqitjes së projektpropozimit të temës së doktoratës me dorëzimin e kërkesës dhe këshilli i njësisë akademike, me propozim të këshillit të studimeve të doktoratës, emëron komisionin për vlerësimin e temës dhe propozimin e mentorit në afat prej një (1) muaji nga data e protokollimit të kërkesës së parashtruar.
4. Kërkesa për vlerësimin e projektpropozimit (formulari F1), përveç shënimeve formale lidhur me doktorantin, duhet të përmbajë edhe të dhënat vijuese:
  - Titulli;

- Rezymeja në gjuhën shqipe dhe angleze;
  - Hyrja;
  - Çështja kërkimore, pyetja/et kërkimore dhe hipoteza/t;
  - Korniza teorike, literatura relevante;
  - Inovacioni, relevanca dhe kontributi i synuar shkencor;
  - Të dhënat dhe metodologjia e propozuar;
  - Metoda/t e analizës së të dhënave;
  - Plani i punës;
  - Referencat.
5. Këshilli i njësisë akademike, me propozim të Këshillit të studimeve të doktoratës, e emëron komisionin për vlerësimin e temës dhe e miraton propozimin për mentorin në afat prej një muaji nga data e protokollimit të kërkesës së parashtruar. Ky komision përbëhet prej tre (3) anëtarëve, nga të cilët së paku një anëtar nuk duhet të jetë mësimdhënës i studimeve në fjalë e as i punësuar në njësinë akademike (fakultetin), e cila është përgjegjëse e studimeve. Mentori i propozuar nuk mund të emërohet në përbërje të komisionit.
  6. Komisioni për vlerësimin e temës jep vlerësimin për kontributin shkencor origjinal ose për kontributin artistik origjinal dhe për zbatueshmërinë e kërimit në pikëpamje financiare dhe organizative, si dhe bën propozimin e mentorit, më së largu brenda një (1) muaji pas paraqitjes së kërkesës (Formulari 2).
  7. Projektpropozimi i punimit të doktoratës mbrohet para Këshillit të studimeve të doktoratës të njësisë akademike, para komisionit për vlerësim dhe mentorit të propozuar, jo më larg se 15 ditë pas dorëzimit të raportit të komisionit për vlerësim.
  8. Këshilli i njësisë akademike, me propozim të këshillit të studimeve të doktoratës, ia propozon temën dhe mentorin për miratim senatit të universitetit (formulari F3). Senati duhet të vendosë rreth propozimit për disertacion brenda dy (2) muajve pas kërkesës. Vendimi mund:
    - Të pranojë propozimin origjinal;
    - Të kërkojë nga doktoranti që të zgjerojë apo ndryshojë temën;
    - Të kërkojë nga këshilli i njësisë akademike të propozojë temë apo/dhe mentor tjetër.
  9. Në rast të rekomandimit pozitiv nga ana e KQSD-së, senati duhet të vendosë rreth propozimit për temën dhe mentorin brenda dy (2) muajve nga momenti i rekomandimit të tillë. Bazuar në vlerësimin pozitiv nga ana e senatit, doktorantit i dorëzohet vendimi përkatës për aprovim të temës së punimit të doktoratës.
  10. Të gjitha hulumtimet shkencore në njerëz (subjekte humane) ose në shtazë doemos duhet të jenë në pajtim me dispozitat e rregullores së Komisionit të Etikës në Kërkim, duhet ta

kenë lejen e Komisionit të Etikës të fakultetit apo universitetit, si dhe të institucionit në të cilin zbatohet hulumtimi; pëlqimin e të gjithë të hulumtuarve veç e veç (pacentëve, përkatësisht vullnetarëve), nëse janë në gjendje ta bëjnë këtë, përkatësisht të kujdestarëve të tyre ose të përfaqësuesit ligjor të tyre.

11. Nëse doktoranti bën kërkesë për ndërrim të mentorit dhe temës, kërkesa duhet të dorëzohet në formë të shkruar dhe të arsyetuar së bashku me deklaratën përkatëse me shkrim të mentorit të deriatëhershëm (formulari F4). KQSD-ja ia propozon senatit vendimin përkatës lidhur me kërkesën e tillë të doktorantit.

### **Neni 13**

#### **Punimi i doktoratës**

1. Disertacioni i doktoratës është një punim shkencor i shkruar nga doktoranti, i cili shtjellon në mënyrë origjinale dhe unike një apo më shumë çështje përkatëse shkencore dhe i cili i nënshtrohet vlerësimit publik shkencor ose artistik.

### **Neni 14**

#### **Format e punimit të doktoratës**

Format e punimit të doktoratës janë:

1. Punimi i doktoratës mund të jetë si:
  - 1.1. Punimi i doktoratës si monografi, e cila përfaqëson një studim shkencor të plotë dhe të pavarur, duke trajtuar në mënyrë të detajuar temën e zgjedhur, problematikën kërkimore dhe kontributin origjinal të hulumtimit. Monografia duhet të përfshijë të gjitha seksionet themelore, përfshirë: abstraktin, hyrjen, shqyrtimin e literaturës/kornizën teorike, metodologjinë, rezultatet, diskutimin, përfundimet dhe listën e referencave (Formulari 5).
  - 1.2. Në formë të përmbledhjes të së paku tre (3) artikujve shkencorë, të botuar në revista me recension ndërkombëtar, të indeksuara në WoS (SCIE, AHCI, dhe SSCI) dhe/ose Scopus (Q1 ose Q2). Në artikujt shkencorë, doktoranti duhet të jetë autor i parë, ndërsa përmbajtja e punimeve duhet të jetë qartazi nga rezultatet e fituara në kuadër të hulumtimeve të doktorantit në lidhje të drejtpërdrejtë me temën e doktoratës. Me kërkesën për mbrojtje të doktoratës, doktoranti dorëzon punimet e publikuara, si dhe një formë të veçantë të përmbledhjes, e cila përmban hyrjen, metodologjinë, rezultatet, diskutimin e përgjithshëm dhe përfundimet kryesore të punës së doktorantit. Përmbledhja e tillë e punimeve konsiderohet ekuivalente me monografinë shkencore.
2. Punimi i doktoratës në fushën artistike është hulumtim artistik origjinal në kontekst të krijimtarisë bashkëkohore artistike dhe mbaron me prezantimin e veprës artistike si dhe me publikimin e një punimi teorik lidhur me veprën e tillë.



## **Neni 15**

### **Gjuha dhe faqosja**

1. Punimi i doktoratës mund të shkruhet në gjuhën shqipe, në gjuhën angleze ose në ndonjë gjuhë tjetër në përdorim ndërkombëtar nëse doktoranti, mentori dhe anëtarët e komisioneve vlerësuese kanë kompetencë në gjuhën përkatëse.
2. Punimi i shkruar në gjuhën shqipe duhet të ketë një përmbledhje në gjuhën angleze. Punimi i shkruar në gjuhë me qarkullim ndërkombëtar duhet të ketë një përmbledhje në gjuhën shqipe dhe angleze. Titulli, përmbledhja dhe fjalët kyçe të punimit të doktoratës duhet të jenë të shkruara patjetër në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Përmbledhja duhet të mundësojë të kuptuarit e qëllimit të punimit, metodave të hulumtimit, rezultateve dhe përfundimeve.
3. Pamja grafike e punimit të doktoratës duhet të jetë në përputhje me udhëzimet e prezantuara në formularin F5.

## **Neni 16**

### **Kohëzgjatja**

1. Doktoranti duhet t'ia dorëzojë këshillit të njësisë akademike punimin e kompletuar të doktoratës për vlerësim brenda tre (3) vjetëve nga dita kur është miratuar tema nga Senati i UP-së. Doktoranti paraprakisht duhet të sigurojë pëlqimin dhe mendimin e mentorit, të shkruar dhe të nënshkruar për hulumtimin e kryer dhe kontributin e arritur shkencor origjinal.
2. Doktoranti mund të kërkojë nga këshilli i njësisë akademike që t'i vazhdohet periudha e disertacionit ose e kërkimeve edhe për një vit.
3. Në rast se kandidati nuk e dorëzon punimin e kompletuar të doktoratës për vlerësim brenda periudhës së rregullt ose të vazhduar të disertacionit, konsiderohet se kandidati heq dorë nga tema e caktuar e disertacionit.

## **Neni 17**

### **Procedura e vlerësimit të punimit të doktoratës**

1. Doktoranti punimin e doktoratës, me pëlqimin dhe mendimin e nënshkruar të mentorit dhe bashkëmentorit (nëse ka) për hulumtimin e kryer dhe kontributin e arritur shkencor origjinal (formulari F6), e dorëzon zyrtarisht në fakultet ose në universitet (nëse studimet organizohen në nivel universiteti). Me këtë rast, doktorantidorëzon edhe deklaratën me shkrim të punës origjinale. Në rast se mentori nuk dëshiron të japë pëlqimin, ka obligim që brenda 15 ditësh të japë me shkrim arsyetimin. Pas kësaj periudhe, në afat prej një (1) muaji pas dorëzimit të arsyetimit të mentorit, Këshilli për studime të doktoratës i njësisë akademike e shqyrton arsyetimin e mentorit dhe i propozon Këshillit të njësisë akademike formimin ose refuzimin e emërimit të komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës.

Në të dyja rastet, arsyetimi i mentorit u jepet anëtarëve të komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës, të cilët do ta kenë parasysh gjatë vlerësimit.

2. Para se të dorëzohet punimi në procedurë për vlerësim, shërbimi i studimeve të doktoratës i njësisë akademike duhet ta vërtetojë me shkrim se doktoranti i ka kryer të gjitha obligimet, ashtu siç është paraparë me programin e studimeve të doktoratës, duke përfshirë deklaratë etike dhe raportin e kontrollit të plagjiaturës (raportin e kontrollit të plagjiaturës kandidati është i obliguar ta ofroj vetëm nëse UP-ja i siguron qasje në softuerin përkatës). Kontrolli i plagjiaturës bëhet përmes programeve kompjuterike të përcaktuara nga Universiteti i Prishtinës dhe jo vetëm.
3. Për vlerësimin e punimit, doktoranti e paraqet punimin në formë të shkruar në letër dhe në formë elektronike. Te veprat artistike të doktorantit, pos prezantimit publik, doktoranti e dorëzon edhe pjesën teorike dhe dokumentacionin përkatës për vlerësimin e punimit.
4. Këshilli i njësisë akademike, me propozim të Këshillit të studimeve të doktoratës, e emëron komisionin për vlerësimin e punimit të doktoratës. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë, prej të cilëve së paku njëri duhet të jetë nga ndonjë universitet jashtë Kosovës. Anëtari nga jashtë Kosovës rekomandohet që të jetë nga një universitet i cili është së paku i ranguar në pozitë më të lartë se Universiteti i Prishtinës në “Times Higher Education Ranking (THE)”. Mentori nuk mund të jetë anëtar i komisionit për vlerësimin e punimit. Komisioni mund të ketë edhe një anëtar rezervë.
5. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës patjetër duhet të kenë së paku titullin akademik profesor asistent (që i plotëson kushtet për mentorim) dhe të jenë të fushës përkatëse.
6. Njëherazi me emërimin e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës, njësia akademike e publikon titullin dhe rezymenë e punimit në gjuhën shqipe dhe angleze në uebfaqen e vet, në kohëzgjatje prej 30 ditësh, dhe në këtë mënyrë mundëson që punimi t'i nënshtrohet kritikës shkencore dhe profesionale.
7. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës dhe të gjithë ata të cilëve u është mundësuar shqyrtimi i punimit të doktoratës janë të obliguar që, para se të paraqitet publikisht vlerësimi, të kenë kujdes me të dhënat dhe arritjet në punimin në fjalë, me qëllim të ruajtjes së kontributit shkencor të punimit të doktoratës si pronë intelektuale.
8. Komisioni për vlerësimin e punimit të doktoratës është i obliguar që brenda dy (2) muajve nga emërimi ta përpilojë raportin e shkruar për vlerësimin e punimit të doktoratës (formulari F8) dhe t'ia dorëzojë këshillit të njësisë akademike. Kryetari i komisionit e përgatit raportin, duke i pasur parasysh vlerësimet me shkrim të anëtarëve të komisionit dhe komentet e mundshme nga diskutimi publik, ndërkaq raportin përfundimtar të përbashkët e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e komisionit. Raporti i përbashkët i komisionit, i shkruar në formularin e universitetit, do të dorëzohet në këshillin e doktoratës të fakultetit përkatës. Në rast të mospajtimit me vlerësim përfundimtar të përbashkët, anëtari i komisionit ka të drejtë të japë vlerësim përfundimtar të veçantë. Raporti i komisionit duhet të përmbajë vlerësimin eksplicit lidhur me kontributin origjinal shkencor/artistik të doktorantit. Varësisht nga niveli i punimit, komisioni po ashtu mund

t'i rekomandojë këshillit të njësisë akademike të kërkojë nga doktoranti plotësimin e punimit ose refuzimin në tërësi të punimit.

9. Në seancën e parë të radhës, këshilli i njësisë akademike, pas raportit të komisionit dhe të Këshillit të studimeve të doktoratës, vendos për:
  - a) Pranimin e disertacionit në versionin e ofruar;
  - b) Refuzimin e disertacionit për shkak të dështimit;
  - c) Kthimin prapa të disertacionin për plotësim apo për ndryshim.
10. Në rast se disertacioni kthehet për plotësim apo për ndryshim, këshilli i njësisë akademike cakton afatin kohor prej 2 deri në 6 muaj, brenda të cilit duhet të bëhet plotësim/ndryshimi i disertacionit.
11. Disertacioni i plotësuar apo i ndryshuar duhet t'i dorëzohet këshillit të njësisë akademike bashkë me mendimin e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës (i cili merr parasysh edhe mendimin e mentorit tjetër ose bashkëmentorit).
12. Me rastin e miratimit të raportit të komisionit për vlerësim, këshilli i njësisë akademike formon komisionin për mbrojtje të doktoratës. Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës përbëhet nga së paku tre (3) anëtarë. Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës mund të jetë në përbërje të njëjtë si komisioni për vlerësimin e punimit të doktoratës.
13. Vendimi pozitiv i këshillit të njësisë akademike lidhur me disertacionin, në afat prej dy (2) muajsh nga data e dorëzimit, shqyrtohet në KQSD, i cili, në rast të plotësimit të kushteve të parapara me këtë rregullore, i propozon senatit ratifikimin e punimit të doktoratës.
14. Senati, në afat prej një (1) muaji nga data e rekomandimit pozitiv të KQSD-së, merr vendim lidhur ratifikimin e punimit të doktoratës.

## **Neni 18**

### **Procedura e mbrojtjes së punimit të doktoratës**

1. Doktoranti, në marrëveshje me dekanin e njësisë akademike dhe me komisionin për mbrojtje të punimit të doktoratës, detyrimisht duhet ta bëjë mbrojtjen publike të punimit të doktoratës brenda afatit prej dy (2) muajve nga dita e ratifikimit në senat.
2. Mentori merr pjesë në mbrojtje të punimit të doktoratës në anën e doktorantit, mirëpo nuk ka të drejtë në vendimmarrje.
3. Mbrojtja e punimit të doktoratës bëhet me prezencë fizike dhe është publike, në raste të veçanta njëri nga anëtarët mund të marrë pjesë edhe në formë virtuale. Thirrja për mbrojtje publike duhet të shpallet në hapësirat e njësisë akademike, në faqen zyrtare të internetit të njësisë akademike dhe të universitetit, së paku tetë ditë kalendarike para mbrojtjes. Mbrojtja duhet të organizohet në hapësirën e universitetit, gjegjësisht të njësisë së tij, në gjuhën në të cilën është shkruar punimi i doktoratës. Në rast të doktoratave të dyfishta dhe të doktoratave të realizuara në kuadër të studimeve të përbashkëta, mbrojtja mund të

organizohet në universitet tjetër. Procedura e mbrojtjes zhvillohet bazuar në protokollin e prezantuar në formularin F9.

4. Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës e bën vlerësimin menjëherë pas mbrojtjes publike të punimit të doktoratës. Vlerësimi i mbrojtjes së punimit të doktoratës mund të jetë:
  - E mbrojtji me sukses të shkëlqyeshëm;
  - E mbrojtji me sukses shumë të mirë;
  - E mbrojtji me sukses të mirë;
  - Nuk e mbrojtji.
5. Në rastet kur komisioni për mbrojtje vlerëson që doktoranti ka dështuar të mbrojë doktoratën për shkak të mosrespektimit të qëllimshëm të procedurave të mbrojtjes, injorimit me dashje të komisionit për mbrojtje ose të ndonjë sjelljeje tjetër në kundërshtim me normat e zakonshme të mbrojtjes, doktoranti humb të drejtën për mbrojtje të punimit të doktoratës.
6. Në rastet kur komisioni për mbrojtje vlerëson që doktoranti ka dështuar të mbrojë doktoratën për shkak të përgatitjes së pamjaftueshme të procesit të mbrojtjes, dështimit në dhënien e përgjigjeve meritore në pyetjet e komisionit ose krijimit të përshtypjes së bazuar për mosnjohje serioze të materies së prezantuar në punim, komisioni mund të marrë vendim që doktorantit t'i ofrohet një periudhë prej 1 viti për përsëritje të procesit të mbrojtjes. Nëse edhe pas tentimit të dytë, doktoranti dështon të mbrojë me sukses punimin e tij, ai/ajo e humb të drejtën për mbrojtje të punimit të doktoratës.
7. Vendimi, bazuar në vlerësimin që rezulton nga procesi i mbrojtjes, merret me shumicë votash të anëtarëve të komisionit për mbrojtje të punimit të doktoratës, të konstatuara me nënshkrimin e tyre.
8. Për procedurën e mbrojtjes përpilohet procesverbali në gjuhën shqipe, e në rast se mbrojtja bëhet në gjuhë tjetër, procesverbali përpilohet edhe në atë gjuhë.

## **Neni 19**

### **Pronësia intelektuale dhe mbrojtja e të dhënave**

1. Në rast se rezultatet e hulumtimit të punimit të doktoratës paraqesin inovacion, i cili ka nevojë të mbrohet me të drejtat e pronës intelektuale, doktoranti dhe mentori për këtë e informojnë KQSD-ës. Në këtë rast, doktoranti, me pëlqim të mentorit, para se ta dorëzojë punimin e doktoratës për vlerësim, mund të bëjë kërkesë që me doktoratën e dorëzuar të veprohet në mënyrë diskrete, deri në momentin e mbrojtjes publike.
2. KQSD e zbaton procedurën për mbrojtje juridike dhe komerciale të rezultateve të hulumtimit, në pajtueshmëri me kornizën ligjore në fuqi.
3. Nëse doktoranti, gjatë punës kërkimore në kuadër të doktoratës, arrin rezultate shkencore, të cilat shpiten deri te shpikja dhe/ose inovacioni, të cilat mbrohen me të drejtat intelektuale

të autorit, atëherë doktoranti së bashku me mentorin duhet të lajmërojnë Këshillin e doktoratës të njësisë akademike, KQSD-në dhe ZÇA-në (ose ndonjë zyrë tjetër që parashihet të themelohet) për këto arritje.

4. Doktoranti, me pëlqimin e mentorit mund të kërkojnë shtyrjen e mbrojtjes së temës së doktoratës në kohëzgjatje prej 1 viti (Formulari F7). Ata mund të kërkojnë që edhe pas mbrojtjes, publikimi i dorëshkrimit të doktoratës të bëhet vetëm pasi që të ketë kaluar periudha kohore prej 1-3 vjet, varësisht nga kërkesa e autorëve që mund të jetë e lidhur me procesin e patentimit dhe komercializimit.
5. Doktoranti ka obligim të autorizojë universitetin t'i ketë dhe t'i përdorë të drejtat e pronësisë intelektuale për komercializim të shpikjes dhe inovacionit dhe për të lejuar kërkimin shkencor të mëtejme, nëse paraqitet nevoja. Doktorantit dhe mentorit i njihet e drejta morale mbi shpikjen apo inovacionin, pavarësisht se kush zotëron të drejtat komerciale mbi shpikjen.
6. Në rast të arritjes së shpikjes ose inovacionit gjatë punës së doktorantit në një projekt të kërkimit, të mbështetur edhe nga industria, autorizimi për të drejtat e pronësisë intelektuale bëhet në bazë të detyrimeve që dalin prej marrëveshjes paraprake midis subjekteve, që e përcakton edhe pronësinë e zbulimit dhe të drejtat e shfrytëzimit/komercializimit të tij.
7. Në rastet e komercializimit, profiti i nxjerrë prej komercializimit të shpikjes shkencore dhe inovacionit i takon universitetit, të cilin ai mund ta përdorë për investime kapitale për kërkime të mëtejme në atë drejtim si dhe për shpërblimin e autorëve të tij në bazë të kontratës së dakorduar dhe kornizën ligjore në fuqi..
8. Në këtë rast, mbrojtja publike mund të shtyhet, në pajtim me doktorantin, më së largu për një vit, nga dita e ratifikimit të punimit në senat. Vendimi për shtyrje të mbrojtjes publike merret nga senati, bazuar në rekomandimin e KQSD-së dhe kërkesën e doktorantit.

## **Neni 20**

### **Publikimi dhe ruajtja e punimit të doktoratës**

1. Punimi i doktoratës në tërësi publikohet në faqet e internetit të universitetit, më së largu një muaj pas mbrojtjes. Informacioni për pjesën praktike të punimit të doktoratës nga fusha artistik shpallet në faqe të internetit të universitetit, më së largu një muaj pas mbrojtjes. Në raste të jashtëzakonshme, bazuar në arsyetimin e argumentuar mirë të të doktoruarit dhe me rekomandim të KQSD-së, senati mund të vendosë që publikimi në faqe të internetit të shtyhet deri në dy vjet.
2. Punimi i doktoratës në formë të shtypur ruhet në një kopje në arkivin e njësisë akademike, një kopje në arkivin e universitetit dhe një kopje në Bibliotekën Qendrore Universitare, si dhe në formë elektronike.
3. Punimi i doktoratës nga fusha artistike ruhet, në përputhje me llojin e veprës, në formë adekuate (në formë të shkruar, në formë fotografie, videoregjistrimi, audioregjistrimi etj.)



në arkivin e njësisë akademike, në arkivin e universitetit, në Bibliotekën Qendrore Universitare, më së largu një muaj pas mbrojtjes.

## **Neni 21**

### **Promovimi**

1. Pas përfundimit të suksesshëm të mbrojtjes së disertacionit, i doktoruari fiton titullin akademik doktor i shkencave (dr. sc.) apo ekuivalente, ndërsa merr të drejtat e plota të gradës akademike dhe të diplomës, me rastin e promovimit, kur edhe e bën betimin dhe nënshkruhet në librin e doktoratës shkencore/artistike të universitetit.
2. Doktoranti duhet që, brenda një muaji pas mbrojtjes, ta plotësojë formularin për promovim në gradën doktor shkence/arti dhe ta dorëzojë në shërbimin e studimeve të doktoratës të njësisë akademike punimin e doktoratës, të lidhur dhe në versionin elektronik për publikim në faqen e internetit të universitetit, gjegjësisht në formë të dokumentacionit të përshtatshëm të punimit të doktoratës në fushën artistike (forma e shkruar, fotografi, videoregjistrim, audio regjistrim etj.).
3. Rektori ia dorëzon doktorantit diplomën e doktoratës në promovimin solemn, në të cilin doktoranti duhet të marrë pjesë personalisht ose, në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes, ta autorizojë me shkrim një person tjetër që ta marrë diplomën për të.
4. Në rast të kërkesës me shkrim për çfarëdo arsye, objektive apo subjektive, doktoranti mund të kërkojë përjashtim nga pjesëmarrja në promovimin solemn (pika 3 e këtij neni) me kusht që ai/ajo kanë përmbushur paraprakisht obligimet e parapara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni.

## **Neni 22**

### **Mënyra e sigurimit të cilësisë së studimeve të doktoratës**

1. Shërbimi i studimeve të doktoratës i njësisë akademike është i obliguar që të kujdeset për mbajtje dhe ruajtje të shënimeve të hollësishme lidhur me punimin hulumtues dhe për kryerjen e detyrave të tjera studimore të çdo doktoranti, duke nënkuptuar këtu planin e obligimeve (përgatitja e dosjes së doktorantit), mbajtjen e shënimeve për numrin e doktorantëve të regjistruar dhe numrin e doktorantëve, të cilët e kanë mbrojtur punimin e doktoratës.
2. Bazuar në raportet vjetore të doktorantëve (formulari F10) dhe të mentorëve (formulari F11), këshilli i studimeve të doktoratës, për çdo vit, e përgatit raportin e vetëvlerësimit lidhur me programin e studimeve të doktoratës (formulari F12) dhe njoftimin përkatës e përcjell në këshillin e fakultetit, ndërsa ky i fundit në Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës dhe senatin e universitetit. Ky raport vjetor mbi vetëvlerësimin i bashkëngjitet kërkesës për riakreditim.
3. Kriteret për vlerësim përfshijnë: produktin shkencor/artistik të mësimdhënësve dhe të doktorantëve, mësimdhënien, cilësinë e punimeve të doktoratës, treguesit statistikorë të

kohëzgjatjes së studimeve, treguesit statistikorë të numrit vjetor të doktorëve të rinj në krahasim me numrin e doktorantëve, si dhe realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

### **Neni 23**

#### **Heqja e titullit të doktorit të shkencës**


1. Titulli akademik “Doktor shkence” mund të hiqet në rast të dëshmisë se:
  - 1.1. Disertacioni nuk ka qenë punim i vetë kandidatit;
  - 1.2. Disertacioni nuk ka qenë si rezultat i arritjes personale të kandidatit;
  - 1.3. Disertacioni është i bazuar në pjesët relevante të rezultateve të mëparshme të botuara shkencore nga individët apo nga institucionet tjera;
  - 1.4. Është plagjiat apo shkelje e të drejtës së autorit;
  - 1.5. Është rezultat i ndonjë praktike tjetër joetike.
2. Ankesa për heqje mund t’i parashtrohet këshillit të njësisë akademike nga ana e çdo individi apo institucioni, e mbështetur me të dhëna të hollësishme me shkrim.
3. Pas ankesës, këshilli i njësisë akademike formon një komision tre (3) anëtarësh nga profesorët e disiplinës së njëjtë shkencore me disertacionin.
4. Anëtarët e komisioneve të disertacionit të ankimuar nuk do të zgjidhen në këtë komision.
5. Komisioni paraqet një raport të vlerësimit në lidhje me arsyeshmërinë e ankesës dhe propozon procedura të mëtutjeshme brenda dy (2) muajve pasi të ketë filluar procedura.
6. Pas raportit dhe propozimit të komisionit, këshilli i njësisë akademike vendos të refuzojë apo të pranojë ankesën për heqje në mbledhjen e ardhshme.
7. Në rast se këshilli i njësisë akademike e pranon ankesën, senati do të votojë për këtë vendim në mbledhjen e ardhshme. Doktor i shkencës në fjalë duhet të ftohet që të dëshmojë para senatit.

### **Neni 24**

#### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja me numër protokolli 937 e datës 26.04.2023 për studimet e doktoratës.
2. Doktorantët që janë regjistruar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të vazhdojnë studimet e doktoratës sipas rregullores që ishte në fuqi në momentin e regjistrimit të studimeve. Për doktorantët që kanë tejkaluar dyfishin e kohëzgjatjes së studimeve, do të zbatohet rregullorja që ishte në fuqi kur atij/asaj i është miratuar për herë të fundit zgjatja e afatit të studimeve.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i UP-së.

4. Njësitë akademike obligohen që ta hartojnë udhëzuesin sipas kësaj rregulloreje.
5. Formularët në vijim janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, me të cilën rregullohet edhe përdorimi i tyre:
- F1 - Paraqitja e temës dhe mentorit;
  - F2 - Vlerësimi i temës, mentorit dhe projektpropozimit të doktoratës;
  - F3 - Vendimi për aprovimin e temës së punimit të doktoratës;
  - F4 - Kërkesa për ndërrim të temës dhe/ose të mentorit;
  - F5 - Udhëzimet për përpilimin e punimit të doktoratës;
  - F6 - Kërkesa për vlerësim të punimit;
  - F7 - Kërkesa për shtyrje të mbrojtjes publike të punimit të doktoratës;
  - F8 - Raporti mbi vlerësimin e punës së doktoratës;
  - F9 - Protokollli dhe procesverbali për mbrojtjen e punimit të doktoratës;
  - F10 - Raporti vjetor i doktorantit;
  - F11 - Raporti vjetor i mentorit për përparimin e doktorantit;
  - F12 - Raporti vjetor lidhur me programin e studimeve të doktoratës.



Kryesuesi i Senatit të Universitetit të Prishtinës

  
Prof. Arben Hajrullahu, rektor